



Të arriturat e ARKEP gjatë 20 viteve në rregullimin e tregut të komunikimeve elektronike dhe postare

Raport Përmbledhës

Të arriturat e ARKEP gjatë 20 viteve në rregullimin e tregut të komunikimeve elektronike dhe postare



*20 vjet besim, transparencë, përkushtim për një të
ardhme të sigurt dhe shoqëri të lidhur*

Puna 20-vjeçare – Historiku i ngjarjeve kryesore

20 vjet më parë, në vitin 2004 fillon punën Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit (ART), i themeluar me Ligjin Nr.2002/7 për Telekomunikacionin që njëherësh shënon një periudhë shumë të rëndësishme për tregun e komunikimeve elektronike.

Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP), si një nga Institucionet e para rregullatore të krijuara, në 20 vitet që nga themelimi i tij, ka luajtur një rol kyç në zhvillimin dhe modernizimin e sektorit të komunikimeve elektronike dhe postare në Kosovë. Duke u bazuar në standardet më të mira ndërkombëtare dhe politikat kombëtare, ARKEP ka kontribuar në një treg të qëndrueshëm, transparent dhe të drejtë për të gjithë aktorët e përfshirë.

Misioni i ARKEP: Përmes aplikimit të parimeve për rregullimin e aktiviteteve të komunikimeve elektronike, t'u mundësohet konsumatorëve ofrimin e shërbimeve me shpejtësi sa më të madhe të mundshme, në një afat sa më të shpejtë kohor, me siguri të lartë, si dhe me çmime të arsyeshme.

Ndër të arriturat kryesore të ARKEP gjatë këtyre dy dekadave:

2004

Dhënia e Licencave të para: Më 30 korrik 2004 lëshohen licencat e para për operatorin Posta dhe Telekom i Kosovës (PTK) për ofrimin e rrjetit dhe shërbimit të telefonisë mobile (GSM) në brezin frekuencor 900MHz (Vala900) dhe ofrimin e rrjetit dhe shërbimit të telefonisë fikse.



Figura 1 – Ceremonia e nënshkrimit të licensës së PTK -së

2005

Më datë 18 maj 2005, ART lëshon 3 autorizimet e para për ofrimin e shërbimeve të internetit nga operatorët: PTK (Dardanet), IPKO dhe Kujtesa. Si rezultat, konsumatorët kosovarë kanë përfituar nga shërbime më cilësore, me çmime më të ulëta dhe me zgjedhje më të mëdha.



Figura 2 – Ceremonia e nënshkrimit të Autorizimeve të operatorëve: PTK, IPKO dhe Kujtesa

Në shtator të vitit 2005, miratohet Rregullorja e parë e ART-së për Licenca dhe Autorizime, objekt i së cilës ishte përcaktimi i llojeve të licencave individuale, tarifat përkatëse të licencimit, procedura dhe kriteret teknike për Licencim.

2007

Në vitin 2007, pas organizimit të tenderit të organizuar nga ART në bashkëpunim me Ministrinë e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit (MTPT), si dhe me mbështetje nga kompania konsulente suedeze AB Stelacon, hyn në treg operatori i dytë i telefonisë mobile IPKO Telecommunications LLC, i autorizuar për ofrim të shërbimeve GSM në brezet frekuencore 900MHz dhe 1800MHz.



Figura 3 – Procesi i vlerësimit të tenderit

2008

Në vitin 2008, pas shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, krijohen kushtet për bartjen e kompetencave nga Institucionet ndërkombëtare dhe këtë rast ARKEP merr kompetencat e plota në menaxhimin e resurseve frekuencore, duke përfshirë stacionin e parë mobil për monitorimin e radio frekuencave. Në po të njëjtin vit, ARKEP rrit kapacitetet e monitorimit duke edhe me një pajisje mobile monitoruese, një pajisje portabile dhe drive test. Kjo shënon një moment shumë të rëndësishëm në monitorimin e shfrytëzueshmërisë së resurseve frekuencore nga operatorët e licencuar dhe zbulimin e atyre të palicencuar.



Figura 4 – Stacionet Mobile Monitoruese: a) MM1-Tadiran dhe b)MM2-R&S

Krahas sistemit të radio monitorimit, në këtë vit krijohet për herë të parë sistemi për menaxhimin e frekuencave i quajtur SPECTRA, i cili përfshinë module shumë të rëndësishme si: SPECTRAemc – për analiza inxhinierike, SPECTRAplus – për administrimin e frekuencave, SPECTRA Plan – për planifikimin e frekuencave, si dhe MonotorPlus – për ndërlidhje me sistemin e radio monitorimit.

Të arriturat e ARKEP gjatë 20 viteve në rregullimin e tregut të komunikimeve elektronike dhe postare




Figura 5 – Sistemi për menaxhimin e frekuencve SPECTRA

2009

ARKEP ka investuar vazhdimisht në zhvillimin profesional dhe trajnimin e stafit të saj, duke njohur rëndësinë e mbështetjes së kapaciteteve të brendshme për të përmbushur sfidat e një sektori gjithnjë në zhvillim. Me përparimin e teknologjisë dhe ndryshimet dinamike të tregut, ARKEP e ka konsideruar trajnimin dhe specializimin e stafit si një prioritet kryesor për të garantuar një rregullim efektiv dhe të qëndrueshëm të shërbimeve telekomunikuese dhe postare.

Nga data 3 deri më 14 gusht 2009, në Washington, D.C., me mbështetjen e Agjencisë së Tregtisë dhe zhvillimit të SHBA-së - USTDA, u realizua njëri nga trajnimet më të rëndësishme që nga themelimi i Rregullatorit. Trajnimi ishte fokusuar në praktikat më të mira për rregullimin e shërbimeve telekomunikuese.



Figura 6 – Trajnimi i stafit të ARKEP në SHBA

2010

Ky vit shënon një tjetër hap të rëndësishëm në fushën e rregullimit të shërbimeve postare. Me miratimin e Ligjit Nr.03/L-173, krahas kompetencave të ARKEP në fushën e komunikimeve elektronike, i ngarkohen kompetenca shtesë në sektorin postar, të cilat në atë koha i ka pasur Ministria përkatëse e linjës Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit.

Kjo shënon një moment të rëndësishëm pasi që është hapi i parë drejt liberalizimit të shërbimeve postare në përputhje me kornizën rregullatore të Bashkimit Europian.

Po në këtë vit ARKEP arrin një sukses të rëndësishëm në ndërprerjen e operimeve ilegale, ku si rezultat i këtij angazhimi:

- Janë larguar dhjetra stacione bazë të operatorëve mobil: Telekom Serbia, Telenor dhe Mobtel.
- Janë identifikuar një numër i konsiderueshëm i ofruesve të shërbimeve të internetit, të cilët kanë ofruar shërbime të qasjes në internet (ISP) pa licencë nga ART. Pas identifikimit të tyre dhe marrjes së masave adekuate në përputhje me legjislacionin në fuqi, është rritur ndjeshëm numri i operatorëve të licencuar.

2011

Në vitin 2011, përmes asistencës ndërkombëtare, para së gjithash nga Qeveria e Norvegjisë, krijohet Nyja për shkëmbimin e trafikut të Internetit e njohur si KOS-IX. Kjo iniciativë ka pasur një ndikim të madh në zhvillimin e infrastrukturës digjitale të Kosovës dhe ka kontribuar në përmirësimin e lidhshmërisë dhe efikasitetit të rrjeteve të internetit.

Në jetësimin e këtij projekti me rëndësi të madhe për Kosovën, përveç implementimit të projektit, ART ka ndërmarrë edhe një sërë aktivitete tjera në aspektin e miratimit të legjislacionit sekondar.



Figura 7 – Njësia Shkëmbyese e Internetit KOS-IX

2012

Viti 2012, shënon një fazë tjetër të rëndësishme në fushëveprimtarinë e ARKEP. Ligji i ri për komunikimet elektronike miratohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, me çka krijohen kushtet më të përshtatshme për rritjen e konkurrencës dhe mbrojtjen e konsumatorit. Në veçanti, me hyrjen në fuqi të këtij ligji është mundësuar: Largimi i regjimit të licencave dhe zëvendësimin me autorizime të përgjithshme; Krijimi i mekanizmave dhe fuqizimin e rolit të konsumatorit; Krijimi i kushteve dhe promovimi i shtrirjes së rrjetave dhe shërbimeve brezgjëra në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Duke pasur parasysh faktin se ky Ligj ka reflektuar avansimin e mëtutjeshme të teknologjive të komunikimit dhe konvergencën e llojeve të ndryshme të shërbimeve përmes rrjetave të komunikimeve elektronike, atëherë ky vit shënon edhe ndërrimin e emrit të Institucionit nga ART në ARKEP.

Gjatë vitit 2012 shënohet një tjetër progres në drejtim të ndërkombëtarizimit të Republikës së Kosovës: rifunksionalizmi dhe fillimi i aktiviteteve të radio amatorizmit në Republikën e Kosovës pas më shumë se dy dekadave, nën përkujdesjen e ART-së dhe në bashkëpunim me radio amatorët ndërkombëtar me mbështetje nga Presidenti i Regjionit të parë të Unionit Ndërkombëtar të Radio Amatorëve (IARU). Gjatë këtij aktiviteti u shpërndanë edhe licencat e para për radio amatorët vendor dhe ata ndërkombëtar si dhe u realizua ceremonia e thirrjeve të para me shenjë e re thirrëse të Republikës së Kosovës - Z6.



Figura 8 – Ceremonia e licensimit të radio amatorëve

2013

Në vitin 2013 krijohet për herë të parë sistemi i monitorimit të kualitetit të shërbimit (QoS), fillimisht me kapacitetet vetëm për monitorimin e thirrjeve dhe SMS e pastaj nga viti 2019 edhe për parametrat e kualitetit të qasjes në internet nga rrjetat fikse dhe mobile. Përmes rregullimeve të qarta dhe mekanizmave të mbikëqyrjes, ARKEP ka monitoruar vazhdimisht cilësinë e shërbimeve të komunikimeve elektronike, duke u siguruar që operatorët t'u përmbahen kërkesave dhe pritshmërive të konsumatorëve.




Figura 9 – Monitorimi i kualitetit të Qasjes në Internet (ARKEP Nettetst)

Të arriturat e ARKEP gjatë 20 viteve në rregullimin e tregut të komunikimeve elektronike dhe postare




Figura 10 – Monitorimi i kualitetit të thirrjeve telefonike (VQT GL)

Ky vit shënon një tjetër ngjarje të rëndësishme, pasi që ARKEP arrin marrëveshjet e para teknike për harmonizimin e kushteve dhe primeve për përdorimin e radio frekuencave të rrjetave të komunikimeve elektronike GSM dhe UMTS në zonën ndërkufitare, dhe atë në brezet e frekuencave; 880 - 915/925 - 960 MHz, 1710 - 1785/1805 - 1880 MHz, 1900 - 1980 MHz, 2010 - 2025 MHz dhe 2110 - 2170 MHz nga ana e operatorëve të rrjeteve.



Figura 11 – Nënshkrimi i marrëveshjes me Rregullatorin nga Mali i Zi EKIP

Gjatë po këtij viti, me datë 10 dhjetor, 2013 ARKEP duke u mbështetur plotësisht në kapacitetet e veta, ka organizuar Ankandin e parë që nga themelimi për dhënien e së drejtës së shfrytëzimit (përdorimit) të brezeve frekuencore

Të arriturat e ARKEP gjatë 20 viteve në rregullimin e tregut të komunikimeve elektronike dhe postare

3400 - 3600 MHz dhe 3600 - 3800 MHz, breze këto të përshtatshme për ofrimin e shërbimeve brezëgjëra (BWA) në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Ankandi i organizuar ka patur për objektiv sigurimin dhe nxitjen e konkurrencës fer dhe efektive në ofrimin e shërbimeve dhe rrjeteve të komunikimeve elektronike, si dhe zbatimin e prioriteteve dhe objektivave zhvillimore ekonomike të vendit dhe objektivave sociale të përcaktuara me Agjendën Digjitale të Kosovës.

2014

Liberalizimi i brezeve frekuencore, ku u është mundësuar operatorëve të telefonisë mobile Telekom i Kosovës dhe IPKO neutraliteti teknologjik. Kjo ka krijuar kushtet që në vitin 2014 operatorët e telefonisë mobile të investojnë në gjeneratat e reja të telefonisë mobile - teknologjinë 4G.

2015

Gjatë vitit 2015 ARKEP themelon Njësinë teknike për Siguri Kibernetike KOS-CERT, e cila është funksionalizuar në vitin 2016. KOS-CERT ka një rol kyç në ruajtjen e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike dhe përdoruseve të rrjeteve dhe shërbimeve publike në Republikën e Kosovës, duke përfshirë të:

- Ndhimjohë komunitetin të përballet në mënyrë efektive me sfidat e sigurisë kibernetike;
- Analizojë dhe parandalojë kërcënimet e sigurisë kibernetike;
- Shkëmbejë informacionet me konstituentët në lidhje me kërcënimet e sigurisë kibernetike,
- Përgatitë dhe shpërndan materiale vetëdijësuese të sigurisë kibernetike, etj.



Figura 12 – Njësia teknike për Sigurinë Kibernetike KOS-CERT

2016

Në fund të vitit 2016, Republikës së Kosovës i alokohet kodi telefonik 383 së bashku me kodet tjera të nevojshme si kodi shtetëror mobil MCC 221 dhe kodi i sinjalizimit ISPC 7-2014. Kjo ngjarje padyshim shënon një epokë të re në sektorin e komunikimeve elektronike duke identifikuar Republikën e Kosovës si shtet dhe gjithashtu shënon fundin e shpenzimeve të operatorëve nga shfrytëzimi i kodeve të huaja: Monakos 377, Sllovenisë 385 dhe Serbisë 381.

Gjatë këtij viti, ARKEP është pranuar si anëtar i asocuar në Institutin Evropian për Standarde të Telekomunikacionit (European Telecommunications Standard Institute - ETSI). ETSI është institut i njohur në fushën e telekomit, që përgatit standarde të pranura në nivel global për fushën e teknologjisë së informimit dhe të telekomunikimit. Standardet e ETSI përdoren në të gjitha vendet e botës, përfshirë edhe Kosovën.

Me rastin e pranimit të Kosovës si anëtar i asocuar në këtë institut, zyrtarëve të ARKEP i ofrohet mundësia e pjesëmarrjes në të gjitha aktivitetet dhe forumet e ETSI, përfshirë edhe në grupet punuese për hartimin e standardeve në fushën e telekomit, asamblenë e përgjithshme të ETSI-së, punëtoritë për zhvillimet në fushën e telekomit, etj.



Figura 13 – Ceremonia e pranimit të certifikatës së antarësimit

2017

Gjatë vitit 2017, ARKEP ka vënë në funksion platformën për aplikim online, e cila është dizajnuar në atë formë që ndërmarrjet që hyjnë në tregun e komunikimeve elektronike nuk kanë nevojë të dorëzojnë aplikacionin në formë fizike në ARKEP, një gjë të tillë mund ta bëjnë përmes plotësimit të aplikacionit online duke bashkangjitur të gjithë dokumentacionin e nevojshëm.

Ky projekt është implementuar në bashkëpunim me “Open Data” dhe është financuar nga UNHCR. Rezultati i këtij projekti është se:

- Krijohen lehtësira të konsiderueshme si për hyrësit e rij në treg dhe operatorët ekzistues për raportimet e tyre periodike, e po ashtu edhe për stafin e ARKEP në eliminimin e vështërsive administrative dhe të panevojshme,
- Rritet siguria dhe besueshmëria e të dhënave përmes prezentimit të një pasqyre reale të indikatorëve të tregut të komunikimeve elektronike.

Si rezultat i zbatimit të marrëveshjes së Telekomunikacionit, më datë 1 maj 2017 përfundimisht janë ndërprerë të gjitha shërbimet e operatorëve të telefonisë mobile "Telenor" dhe "ViP mobile", të cilët që nga pas lufta kanë vepruar në mënyrë të paautorizuar në territorin e Republikës së Kosovës.

Njëherësh, me qëllim të ofrimit të shërbimeve sa më cilësore dhe plotësimin e nevojave për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, ARKEP ka udhëzuar dhe mbështur operatorët Telekom i Kosovës dhe IPKO që të rrisin mbulueshmërinë edhe në pjesën veriore të vendit.

2019

Në vitin 2019 ARKEP ka realizuar Ripërtëritjen e Autorizimeve Individuale për të drejtën e shfrytëzimit të kapaciteteve frekuencore në brezet 900 MHz dhe 1800 MHz për Operatorët “Telekomi i Kosovës Sh.A” dhe “IPKO Telecommunications LLC. Autorizimet janë lëshuar për periudhën prej 20 vitesh.



Figura 14 – Ceremonia e nënshkrimit të autorizimeve

Në drejtim të ndërkombëtarizimit të punës së ARKEP, fundi i vitit 2018 ka rezultuar edhe me ndërrimin e rregullores së Bashkimit Evropian për Entin e Rregullatorëve të Komunikimeve Elektronike (BEREC), me çrast Republikës së Kosovës, përkatësisht ARKEP-it nga viti 2019 i mundësohet për herë të parë të marrë pjesë në të gjitha nivelet e punës së këtij enti, që është organi më i rëndësishëm evropian për fushën e komunikimeve elektronike.



Figura 15 – Pjesëmarrja e ARKEP në seancat plenare të BEREC-ut

Po në këtë vit nënshkruhet marrëveshja rajonale e roamingut në mes shteteve të Ballkanit Perëndimor, dhe ARKEP ka qenë institucioni kryesor për finalizimin dhe zbatimin e kësaj marrëveshje.




Figura 16 – Ceremonia e nënshkrimit të marrëveshjes rajonale të Roamingut

2021

Në vitin 2021, miratohet Ligji për masat për uljen e kostos së shtrirjes së rrjetave të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë, i cili ka transpozuar Direktivën e BE-së 2014/61/EU dhe ka për qëllim të përmirësojë efikasitetin e infrastrukturave, duke nxitur lidhjen më të mirë dhe shërbime të kapacitetit të

lartë dhe internet më të shpejtë për të gjithë qytetarët. **Me hyrjen në fuqi të këtij Ligji, ARKEP merr kompetenca shtesë si organi i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve midis operatorëve dhe pronarëve të infrastrukturës.**

Nga data 1 korrik 2021, hynë në fuqi Roam Like at Home - RLAH ku konsumatorët gjatë qëndrimit në njërin nga vendet e Ballkanit Perëndimor (WB6) nuk do të paguajnë asnjë tarifë shtesë për shërbimet e rregulluara të roamingut (thirrjet e realizuara ose pranuar, SMS-ët e dërguar dhe të dhënat/data të shfrytëzuara), përveç tarifës e cila aplikohet në Republikën e Kosovës.

2022

Në vitin 2022, ARKEP me mbështetjen e Ministrisë së Ekonomisë përmes projektit KODE, arrin që të implementoj sistemin nacional të monitorimit të radio spektrit (SNMS) që shënon një arritje shumë të rëndësishme me rëndësi të madhe nacionale që ka pasur direkt ndikim në përmirësimin e sigurisë kombëtare. Funkcionalizimi i Sistemit Nacional për Monitorimin e Radio Frekuencave, që ka përmirësuar dukshëm aftësinë e ARKEP për të mbikëqyrur dhe menaxhuar përdorimin e frekuencave, duke rritur sigurinë dhe efikasitetin e rrjeteve të komunikimeve elektronikë në vend. Aktualisht ARKEP ka 4 stacione fikse të monitorimit të spektrit 24 orë në ditë dhe 7 ditë në javë, të cilat janë të vendosura në lokacionet më strategjike të vendit. Po ashtu përmes pajisjeve mobile monitoruese, ARKEP arrinë që të ketë qasje dhe monitoroj shfrytëzueshmërinë e brezeve frekuencore në tërë territorin e Republikës së Kosovës.




Figura 17 – Ceremonia e përrimit të SNMS (Stacioni Fiks në Mitrovicë)



Figura 18 – Prezentimi i SNMS

Gjatë vitit 2022t, ARKEP ka miratuar Planin e ri për hapjen e brezeve me rëndësi të posaçme ekonomike për ofrimin e shërbimeve mobile IMT: 700MHz, 800MHz, 900MHz, 1800MHz, 2.1GHz, 2.6GHz, 3.5GHz dhe brezin 26GHz.

2023

Në shkurt të vitit 2023, ARKEP pas një pune intensive ka lëshuar autorizimet e para për operatorët mobil Telekom i Kosovës dhe IPKO Telecommunications në brezet frekuencore 800 MHz dhe 3.6 GHz, duke krijuar kushtet për investime edhe në teknologjinë 5G.

- Këto resurse frekuencore janë caktuar në shfrytëzim sipas parimit të neutralitetit teknologjik dhe do jenë në dispozicion për shfrytëzim efektiv për periudhën njëzet vjeçare. Përveç kësaj, ARKEP u ka krijuar lehtësira të shumta operatorëve duke filluar nga çmimi për spektër ndër më të ulët në Evropë, pastaj mundësia e pagesës në këste si dhe mundësi tjera, të cilat ndikojnë në shtrirjen më të shpejtë të rrjetave 5G.
- Në anën tjetër, me qëllim të arritjes së objektivave rregullatorë, ARKEP ka vendosur obligime për operatorët sa i përket mbulueshmërisë si dhe sigurinë dhe integritetin e rrjetit, në veçanti sa i përket prodhuesve të

Të arriturat e ARKEP gjatë 20 viteve në rregullimin e tregut të komunikimeve elektronike dhe postare

dyshimtë.



Figura 19 – Ceremonia e nënshkrimit të Autorizimeve individuale për operatorët Telekomit i Kosovës dhe IPKO Telecommunications LLC.

Po ashtu ARKEP më datë 6 shkurt 2023, ka miratuar dhënien e së drejtës për përdorimin e kapacitetit frekuencor prej 90 MHz (3710 - 3800 GHz) për rrjetin privat 5G në nivel lokal/rrjet i mbyllur jo komercial, i cili njëherit është autorizimi i parë në rajon për rrjeta të tilla. Shfrytëzimi i këtyre resurseve për rrjetat private 5G do t'u mundësoj ngritjen profesionale lidhur me zhvillimet e reja teknologjike.

Gjatë këtij viti ARKEP ka nënshkruar Marrëveshjeve teknike për harmonizimin e shfrytëzimit të frekuencave në brezet 800, 900, 1800, 2100, 2600 dhe 3600 MHz, të rrjetave MFCN në zonat ndërkufitare të Republikës së Kosovës, me Shqipërinë, Malin e Zi dhe Republikën e Maqedonisë së Veriut.



Figura 20– Ceremonia e nënshkrimit të Marrëveshjeve teknike rajonale

Gjatë vitit 2023 në vazhden e rritjes së mëtutjeshme të bashkëpunimit rajonal është nënshkruar Memorandumi i Mirëkuptimit në mes të ARKEP dhe Rregullatorit homolog AKEP nga Republikës së Shqipërisë. Qëllimi i këtij Memorandumi është bashkëpunimi midis palëve në hartimin e akteve normative dhe programeve për të adresuar sfidat rregullatore në dy vendet nënshkruese të memorandumit bazuar në praktikat e mira të BE-së dhe angazhimet ndërkombëtare.

Ky memorandum është njëri nga marrëveshjet e shumta të nënshkruara me Rregullatorët e shteteve fqinjë dhe më gjerë si: Maqedonia e Veriut, Sllovenia, Turqia, Mali i Zi, Letonia, Kroacia, etj.



Figura 21 – Nënshkrimi i MoU-ve me AKEP dhe AEC

ARKEP gjatë vitit 2023 si objektivë kryesore ka pasur fuqizimin e mëtutjeshëm të drejtave të konsumatorëve (Objektiv Strategjike - Konsumatori në Qendër). Në veçanti, rregullat e reja të miratuara nga ARKEP konsistojnë në:

Të arriturat e ARKEP gjatë 20 viteve në rregullimin e tregut të komunikimeve elektronike dhe postare

- Vendosjen e obligimeve shtesë për operatorët sa i përket rritjes së transparencës dhe informimit të konsumatorëve lidhur me të drejtat e tyre;
- Vendosjen e kërkesave specifike sa i përket kualitetit të shërbimeve të komunikimeve elektronike, me fokus në shërbimet e qasjes në internet dhe kualitetin e shërbimit të thirrjeve me zë;
- Ofrimin e mundësisë për konsumatorët për ndërprerjen e kontratës, për rastin e pakove të kombinuara, atëherë kur ka ndryshim për cilindo element të pakos. Në rast të ndryshimeve në kushtet e kontratës për qasje në shërbimet mediale audio vizuale, konstatimet do t'i jap autoriteti kompetent – Komisioni i Pavarur për Media (KPM);
- Përcaktimin e procedurës për paraqitjen e ankesave, zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe mënyrës së kompensimit.

Për të mbikëqyrur përmbushjen e obligimeve të parapara me rregullat e reja të miratuara, ARKEP ka themeluar një departament të veçantë, i cili do të merret me mbikëqyrjen e tregut dhe mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve.

2024

Pas miratimit të Rregullores për bartshmërinë e numrave në vitin 2023, si dhe zgjedhjes së Ofruesit të shërbimit të bartshmërisë së numrave nga operatorët e autorizuar, ARKEP më datë 3 korrik 2024 ka dhënë autorizimin për zbatimin e bartshmërisë së numrave në rrjetet e komunikimeve elektronike mobile dhe fikse. Ky zhvillim i rëndësishëm vjen si pjesë e përpjekjeve tona të vazhdueshme dhe intenzive për të përmirësuar shërbimet e komunikimeve elektronike dhe për të krijuar një mjedis më të favorshëm dhe konkurrues në treg.

Bartshmëria e numrave është një shërbim që u mundëson përdoruesve të ruajnë numrat e tyre ekzistues të telefonit kur kalojnë nga një ofrues i shërbimit në një tjetër, pa marrë parasysh nëse është një rrjet mobil apo fiks. Ky proces është i rëndësishëm për të rritur konkurrencën mes ofruesve të shërbimeve dhe për të ofruar më shumë zgjedhje dhe fleksibilitet për konsumatorët.

Përfitimet për Konsumatorët:

- **Fleksibilitet:** Konsumatorët mund të kalojnë nga një ofrues i shërbimit në një tjetër pa humbur numrin e tyre të telefonit.
- **Konkurrencë më e madhe:** Rritja e konkurrencës mes ofruesve të shërbimeve do të nxisë përmirësimin e kualitetit të shërbimeve dhe ofrimin e shërbimeve me kosto më të përballueshme për konsumatorët.

Të arriturat e ARKEP gjatë 20 viteve në rregullimin e tregut të komunikimeve elektronike dhe postare

- **Përmirësimi i Shërbimeve:** Me mundësinë e ruajtjes së numrit, përdoruesit do të kenë qasje më të lehtë në shërbimet më të mira dhe më të përshtatshme për ta.

Në përputhje me Kornizën rregullatore të komunikimeve elektronike, pas diskutimeve të zhvilluara, operatorët më datë 19 korrik 2024, kanë nënshkruar kontratën multilaterale me ofruesin e shërbimit të Bartshmërisë së Numrave.

Bashkëpunimi ndërkombëtar

Anëtarësimi dhe pjesëmarrja në mekanizmat ndërkombëtar është një element tjetër i rëndësishëm në punën dhe veprimtarinë e ARKEP. Ky bashkëpunim ndërkombëtar është një komponent kyç në përmbushjen e objektivave të ARKEP për të siguruar një mjedis të drejtë dhe të qëndrueshëm të konkurrencës, si dhe për të mbështetur përmirësimin e standardeve dhe përvojës në sektorët që mbulon.

Në këtë kuadër, ARKEP merr pjesë si anëtar ose vëzhgues në shumë institucione dhe organizata ndërkombëtare, duke kontribuar në proceset e zhvillimit të rregulloreve, praktikave dhe standardeve që ndikojnë drejtpërdrejtë në funksionimin e tregjeve të komunikimeve elektronike. Disa nga organizatat më të rëndësishme ku ARKEP është i përfshirë janë:



BEREC (Body of European Regulators for Electronic Communications): ARKEP është pjesëmarrës aktiv në takimet e grupeve punuese të ekspertëve (gjithësej 10 grupe) të BEREC, përfshirë takimet plenare të Udhëheqësve të Rregullatorëve. BEREC është një forum i rregullatorëve të komunikimeve elektronike të Bashkimit Evropian, që ka për qëllim të sigurojë një treg të hapur dhe konkurrues për komunikimet elektronike në nivel evropian.



ETSI (European Telecommunications Standards Institute): ARKEP nga viti 2016 është pranuar si anëtar i asociuar në ETSI, një organizatë ndërkombëtare që zhvillon dhe promovon standarde të teknologjive të komunikimit dhe informacionit, për të siguruar që normat dhe teknologjitë e reja të adoptohen dhe të implementohen me sukses.



EURO-IX (European Internet Exchange Association): ARKEP nga viti 2013 është pjesë e Euro-IX, një organizatë që mbështet dhe promovon zhvillimin e shkëmbimit të trafikut të internetit në nivel evropian, duke siguruar që infrastruktura e internetit të jetë e shpejtë dhe e besueshme.



CEPT ECC (European Conference of Postal and Telecommunications Administrations - Electronic Communications Committee): ARKEP nga viti 2024 merr pjesë në aktivitetet e CEPT ECC, një organizatë që promovon bashkëpunimin ndërmjet administratave dhe rregullatorëve të telekomunikacioneve dhe postës në Evropë, për të siguruar një zhvillim të koordinuar të politikave dhe rregulloreve. Ekspertët e ARKEP marrin pjesë në: Numbering and Networks WG (WG NaN); Frequency Management Working Group (WG FM); Spectrum Engineering Working Group (WG SE); IMT Matters – ECC PT1; dhe FM22 –Radio Monitorimi i frekuencave.



Trusted Introducer: Pas themelimit të njësisë teknike KOS-CERT, nga viti 2017 është akredituar nga Trusted Introducer. Ky është një rrjet që ofron shërbime të sigurisë kibernetike dhe autentifikimin e identitetit për ofruesit e shërbimeve të internetit dhe të telekomunikacionit. ARKEP angazhohet aktivisht për të mbështetur përmirësimin e sigurisë dhe besueshmërisë në sektorët e tij.

Sot

Me përkushtimin e vazhdueshëm të ARKEP, është jetësuar implementimi me sukses i synimeve dhe objektivave kryesore gjithnjë të mbështetura dhe të bazuara mbi parimet bazë të ligjit dhe objektivave për rregullimin e aktiviteteve të komunikimeve elektronike, të cilat në formë të përmbledhur paraqiten si më poshtë:

- **Transparenca** - bërjen publike të informacioneve relevante dhe dhënien e hapësirës së nevojshme për palët e interesit që të japin kontributin e tyre gjatë hartimit të dokumenteve të ndryshme rregullatore;
- **Mosdiskriminimi** - administrimi i vendimeve dhe akteve tjera normative në mënyrë transparente dhe neutrale nga aspekti i konkurrencës;

Të arriturat e ARKEP gjatë 20 viteve në rregullimin e tregut të komunikimeve elektronike dhe postare

- **Pavarësia** - hartimi i akteve normative në mënyrë të pavarur dhe paanshëm, duke siguruar përgjegjësi në raport me pjesëmarrësit në treg;
- **Efikasiteti** - eliminimi i barrierave të panevojshme në tregun e komunikimeve elektronike dhe atij postar dhe rregullimi minimal i domosdoshëm.

I udhëhequr nga këto parime dhe duke iu referuar praktikave të mira të vendeve tjera, sot, 20 vjet pas themelimit, si rezultat i punës, përkushtimit dhe vizionit të ARKEP, janë arritur këto rezultate:

- 1. Modernizimi i Infrastrukturës së Komunikimeve Elektronike** - Me mbështetjen dhe rregullimin nga ARKEP, Kosova ka arritur të zhvillojë një infrastrukturë moderne të komunikimeve elektronike, përfshirë zgjerimin e rrjeteve të gjeneratës së re (NGN) dhe rrjetet mobile të gjeneratës së tretë, katërt dhe së fundi shtrirja e rrjetave 5G. Si rezultat, shtrirja e rrjetave fikse të kapacitetit të lartë ka arritur penetrimin 100% për shtëpi, ndërsa penetrimi i shërbimeve mobile brezgjëra ka arritur vlerën mbi 105%. Sot kemi një shtrirje të rrjetave 5G pothuajse në të gjitha qytetet e Republikës së Kosovës. Kjo ka mundësuar përfshirjen më të gjerë të popullsisë në shërbimet digjitale dhe përmirësimin e lidhshmërisë në të gjithë vendin.
- 2. Krijimi i Kornizës së përshtatshme rregullatore** - Janë miratuar mbi 40 Rregullore, të cilat janë në fuqi për rregullimin e tregut të komunikimeve elektronike dhe atij postar. Rrjedhimisht, duke vazhduar me eliminimin e barrierave të panevojshme dhe krijimin e kushteve më të favorshme për investime në këtë sektor, sot në vitin 2024 kemi arritur që t'i kemi 123 ndërmarrje, të cilat ofrojnë shërbime të komunikimeve elektronike, respektivisht 30 ndërmarrje të shërbimeve postare. ARKEP gjatë vitit ka lëshuar autorizimin e përgjithshëm për kompaninë Starlink, një lider global për ofrimin e shërbimeve satelitore të qasjes në internet. Ky autorizim përfaqëson një hap të rëndësishëm për avansimin e infrastrukturës digjitale në vend dhe ofron mundësi të shumta për ofrimin e qasjes në internet në çdo lokacion të territorit të Republikës së Kosovës. Në të gjithë globin, Starlink u ka mundësuar komuniteteve në nevojë të kenë qasje në arsim, shërbime shëndetësore, të mundësojnë punën në distancë dhe të ofrojnë mbështetje kritike të komunikimit gjatë fatkeqësive natyrore ose raste tjera të emergjencave kombëtare.
- 3. Rregullimi dhe Monitorimi i Kualitetit të Shërbimeve** - Një tjetër aspekt i rëndësishëm ka qenë rritja e standardeve për ckaualitetin e shërbimeve të ofruara për qytetarët. Përmes rregullimeve të qarta dhe mekanizmave të mbikëqyrjes, ARKEP ka monitoruar vazhdimisht kualitetin e shërbimeve të komunikimeve elektronike, duke u siguruar që operatorët t'u përmbahen kërkesave dhe pritshmërive të konsumatorëve. Sot, përmes sistemeve të implementuara, ARKEP monitorin mbi 140 parametra të kualitetit në përputhje të plotë me udhëzimet dhe rekomandimet e Institucioneve relevante ndërkombëtare si: BEREC, ITU, etj.
- 4. Menaxhimi efikas dhe efektiv i Resurseve Frekuencore** - Menaxhimi i spektrit të frekuencave ka qenë një nga detyrat kryesore të ARKEP, duke siguruar një shpërndarje të drejtë dhe efikase të këtij resursi të kufizuar. Përmes politikave të mira të menaxhimit të spektrit, ARKEP ka mundësuar zhvillimin e shërbimeve të reja dhe zgjerimin e mbulimit të rrjeteve të komunikimeve mobile brezgjëra. Sot, ARKEP posedon sistemin nacional të radiomonitorimit i

Të arriturat e ARKEP gjatë 20 viteve në rregullimin e tregut të komunikimeve elektronike dhe postare

teknologjisë së fundit dhe po ashtu sistemin e menaxhimit të frekuencave të implementuara nga prodhuesit më të njohur ndërkombëtar.

5. **Bashkëpunimi Ndërkombëtar** - Gjatë këtyre 20 viteve, ARKEP ka ndërtuar marrëdhënie të forta me institucione dhe organizata ndërkombëtare, përfshirë ato të Bashkimit Evropian dhe Autoritetet Rregullatore të vendeve përkatëse. Pjesëmarrja në takimet rajonale dhe ato evropiane ka përshpejtuar procesin e harmonizimit të sektorit të komunikimeve elektronike dhe postare me standardet ndërkombëtare.
6. **Rritja e Qasjes dhe Përdorimit të Shërbimeve Postare** - ARKEP ka mbështetur gjithashtu modernizimin e sektorit postar, duke përmirësuar qasjen në shërbimet postare dhe duke siguruar që këto shërbime të jenë të përballueshme dhe efikase. Përmes rregullave dhe udhëzimeve të qarta, është mundur që sektori postar të funksionojë në mënyrë të qëndrueshme dhe në përputhje me nevojat e qytetarëve dhe biznesit.
7. **Promovimi i Shërbimeve Digjitale dhe Inovacionit** - Duke mbështetur politikat e zhvillimit të agjendës digjitale, ARKEP ka luajtur një rol aktiv në nxitjen e zhvillimit të shërbimeve digjitale dhe inovacionit në sektorin e komunikimeve elektronike. Kjo ka ndihmuar në përshpejtimin e procesit të digjitalizimit në Kosovë dhe në krijimin e mundësive të reja për bizneset dhe qytetarët. ARKEP gjatë vitit 2024 ka filluar me sistem-platformën DIGIT-ARKEP që do të mundësojë menaxhimin e punëve në Autoritet si dhe qasjen e Operatorëve për aplikime, notifikime, raportime për shërbime të ndryshme telekomunikuese. Pra, përmes sistemit DIGIT-ARKEP do të digjitalizohen proceset brenda Autoritetit, i cili sistem është i bazuar në sisteme modulare për secilin Departament brenda Autoritetit.
8. **Mbrojtja e Interesit të vendit** – Duke zbatuar në përpikëri kornizën rregullatore në fushën e komunikimeve elektronike dhe postare, në mënyrë të paanshme, jo diskriminuese dhe transparente, ARKEP ka arritur të mbrojë edhe interesin e vendit. Në të gjitha proceset gjyqësore me palët tjera, që nga themelimi e deri më sot, asnjë rast i vetëm nuk është humbur nga ARKEP.
9. **Ngritja e kapaciteteve humane** – Përmes programeve të ndryshme të trajnimeve në kompanitë më të njohura të specializuara ndërkombëtare, ARKEP ka arritur që të forcoj kapacitetet e brendshme të saj, por edhe përmirësimin e cilësisë së rregullimit dhe mbikëqyrjes së sektorit të komunikimeve elektronike dhe postare, duke mundur një rregullim më të përshtatshëm dhe të efektshëm të tregut dhe mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve. ARKEP vazhdon të angazhohet për krijimin e mundësive të vazhdueshme të trajnimit, duke aftësuar stafin e saj të përballon me sfidat dhe mundësitë që ofron një industri e telekomunikimeve dhe teknologjisë gjithnjë në zhvillim.

Sfidat dhe vizioni për të ardhmen

ARKEP është koshient se jemi duke jetuar në një epokë të përcaktuar nga avancimet e shpejta teknologjike. Epoka digjitale ka revolucionarizuar mënyrën se si jetojmë, punojmë dhe ndërveprojmë me njëri-tjetrin. Rrjetet e komunikimeve elektronike janë infrastrukturat, jo vetëm që janë të rëndësishme për vet sektorin, por padyshim kyçe në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik, duke përmirësuar shërbimet publike dhe mbështur sigurinë kombëtare.

Në këtë kontekst, roli i ARKEP si rregullator nacional nuk është thjesht të krijoj Korniza Rregullatore, por të parashikoj ndryshimet. Prandaj, duke qenë të vetëdijshëm se kemi shumë punë përpara në fusha të tilla si: konektiviteti për të gjithë, me fokus në rrjetet me kapacitet të lartë (VHCN), transformimi digjital, inteligjenca artificiale, siguria dhe qëndrueshmëria e rrjeteve, trajtimi i shërbimeve të reja, industria 4.0, është e qartë që suksesi mund të sigurohet vetëm nëse ARKEP i prinë procesit të transformimit për t'iu përshtatur nevojave të tregut.

Prandaj, duke pasur parasysh se kemi të bëjmë me një treg, i cili është duke evoluar me shpejtësi, ARKEP në arritjen e objektivave të përcaktuara me Agjenden Digjitale 2030 do të bazohet në shtatë orientime strategjike të identifikuara. Këto objektiva përfshijnë:

- (a) Sigurimin e krijimit të kornizës rregullatore, e cila është në hap me kohën dhe i adreson nevojat e tregut, promovon inovacionin gjithnjë duke i ruajtur interesat publike të vendit;
- (b) Promovimin e mëtutjeshëm të shtrirjes së rrjetave të kapacitetit të lartë (VHCN), duke përfshirë rrjetat 5G dhe ato të gjeneratave të ardhshme në tërë territorin e Republikës së Kosovës, duke ofruar lidhje Gbps për të gjithë qytetarët;
- (c) Krijimin e mekanizmave të përshtatshëm për ofrimin e sigurisë dhe qëndrueshmërisë së rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike;
- (d) Rritjen e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar për të promovuar interesat e vendit dhe nxitur investimet në sektor;
- (e) Antaresimin e mëtutjeshëm në Institucione dhe organizata ndërkombëtare në fushën e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare.
- (f) mbrojtjen e të drejtave të konsumatorit dhe
- (g) forcimin e fleksibilitetit, pavarësisë, gjithëpërfshirjes dhe efikasitetit të ARKEP-it si një qendër e ekspertizës.

Të arriturat e ARKEP gjatë 20 viteve në rregullimin e tregut të komunikimeve elektronike dhe postare



Figura 22 – Staf i ART-së në vitin 2006

Të arriturat e ARKEP gjatë 20 viteve në rregullimin e tregut të komunikimeve elektronike dhe postare



Figura 23 – Stafi i ARKEP në vitin 2024

Të arriturat e ARKEP gjatë 20 viteve në rregullimin e tregut të komunikimeve elektronike dhe postare

Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP)

info@arkep-rks.org